

RREGULLORE

Mbi ndalimin e konsumit të duhanit në mjediset e Tirana International Airport "Nene Tereza"

Në zbatim të Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004 PER RATIFIKIMIN E MARREVESHJES SE KONCESIONIT, NDERMJET KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE SHOQERISE KONCESIONARE "TIRANA AIRPORT PARTNERS", SHPK, PER NDERTIMIN, VENIEN NE PUNE, OPERIMIN DHE MIREMBAJTJEN E AEROPORTIT NDERKOMBETAR "NENE TEREZA", TIRANE DHE PER DHENIEN E DISA STIMUJVE KESAJ SHOQERIE KONCESIONARE si dhe te detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 9636, date 06.11.2006 "Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit" (i ndryshuar) me Ligjin Nr. 76/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9636, datë 06.11.2006", duke qene se "Tirana International Airport" SHPK (quajtur me pare "*Tirana Airport Partners*"), eshte subjekti qe menaxhon Tirana International Airport "Nene Tereza" si dhe te gjitha ambjentet brenda zones se koncensionit, pervec kur keto ambjente jane kontraktuar tek persona te trete per menaxhim dhe operim, keto persona do te jene pergjegjes, në kuadrin e parandalimit të pasojave të dëmshme që sjell duhani në shëndetin e njeriut, miratohet kjo rregullore e cila,

VENDOS: Neni 1

Ndalohet konsumi i duhanit ne te gjithe ambjentet e mbyllura brenda zones se koncensionit Tirana Internationa Airport, por pa u kufizuar, si:

- a) Terminali dhe Kargo;
- b) Godina e Administrates;
- b) Dyqanet;
- c) Magazinat;
- d) Lokalet;
- e) Mjedise e perbashketa te mbyllura te qarkullimit
- f) Godina e Sherbimit te Zjarrefikseve;
- g) Zyrat;
- h) Korridoret;
- i) Tualetet;
- j) Mjediset e përbashkëta të qarkullimit brenda godinës.

Shenja lehtesisht te dallueshme me paralajmerimin "NDALOHET DUHANI" do te vendosen te gjitha vendet e listuara me siper. Departamenti i Menaxhimit te Aseteve dhe Mjedisit do te jete pergjegjes per permbushjen e ketij detyrimi. Per shmangie te cdo dyshimi, edhe ne ato ambjente te mbyllura ku shenjat paralajmeruese mungojne, pirja e duhanit do te jete e ndaluar.

Neni 2

Në faqen zyrtare të TIA do të publikohet në vend të dukshëm, një mesazh informues mbi kufizimet e konsumimit të duhanit ne Tirana International Airport "Nene Tereza". Për përmbushjen e këtij detyrimi ngarkohet Departamenti i IT dhe i Komunikimeve.

Neni 3

3.1 Cdo pasagjere dhe/ose cdo person tjetër qe do te identifikohet duke konsumuar duhan ne vendet e percaktuara sipas nenit 1, do të mbaj pergjegjesi drejtperdrejt dhe do te ndërmerren masa në zbatim të nenit 20/ë të Ligjit Nr. 9636, date 06.11.2006 "Për mbrojtjen e Shëndetit nga

